

# Partitë politike


# Çfarë është një parti politike

- Një parti politike është një grup njerëzish që kërkojnë të kontrollojnë qeverisjen nëpërmjet fitimit të zgjedhjeve dhe mbajtjes së zyrave publike – ky vlen edhe për dy partitë tona kryesore.
- Një parti politike është një grup njerëzish që grumbullohen së bashku mbi disa parime të përgjithshme të përbashkëta që kërkojnë të kontrollojnë qeverisjen me qëllim për të ndikuar disa politika publike dhe programe konkrete.

# C' kuptojme me partite politike

Një parti politike është një "grup qytetarësh me qëndrime të njëjta, qëllimi i të cilëve është realizimi i pikëpamjeve politike". Apo: "një parti politike shpreh një bashkim të lirë qytetarësh me pozicionime të njëjta apo të përafërta, që për zgjidhjen e shumë problemeve politike-ekonomike e social-kulturore harton, mbështet dhe realizon propozimet përkatëse programore. Ndërsa, në procesin zgjedhor paraqet kandidatët e saj për t'u përfaqësuar në parlament apo në organet vendore. Pas fitimit të zgjedhjeve nëpërmjet përfaqësimit politik zbaton në praktikë programin e vet."

Si formohet një parti politike ?



Përfaqësimi politik i popullit është kriter bazë i partisë politike. Pra, ajo dallohet p.sh. nga bashkësi, të cilat nuk bartin përgjegjësi politike në tërësi, apo nga iniciativat qytetare, pjesëmarrja e të cilave nuk është e rregullt dhe të cilat nuk synojnë poste politike.

Sipas perkufizimit te mesiperme: **Partia politike, në përgjithësi, është një bashkim njerëzish me orientim dhe botëkuptim të njëjtë apo të ngjashëm: politik, social, ekonomik, qëllimi i të cilit është ndikimi i jetës shtetërore.**

**Parti si formime grupesh me lidhje jo të forta kane ekzistuar edhe në qytetet-shtete të kohës së lashtë, në Romën republikane, si dhe në lëvizjet politike e fetare të shek. XVI e XVII.** Partitë moderne, si organizata me strukturë përgjithësisht të qëndrueshme, u shfaqen në shek. XVII dhe XIX (me ndikim nga shembulli i jetës politike në Angli; aty në shek. XVIII, si parti me te qëndrueshme, u formuan Torët (Tories) dhe Uigsët (Whigs), të cilat u pozicionuan qarte në çështje të caktuara politike dhe qeverisjen e vendit (sistemi dypartiak)). Grupe partiake u shfaqen në lufterat amerikane për pavarësi, në revolucionin francez apo lëvizjet gjermane për kushtetutë...

**Qëllimi i një partie apo i një grupi partishë në koalicion është fitimi apo ruajtja e shumicës në parlament (partitë e koalicionit, partia shumicë) dhe fitimi në këtë mënyrë i ndikimit mbizotruës politik, pra dhe i qeverisjes.** Loja reciproke e partive politike paraqet një rëndësi të parakushtet themelore të jetës moderne kushtetuese, posaçërisht të sistemit parlamentar (**por jo ate te sistemit njepartiak**). Por, edhe pse partitë politike mishërojnë elemente themelore dhe përcaktuese të jetës kushtetuese, ato në jo pak raste nuk “posedojnë” **njohje në aspektin e të drejtës kushtetuese, për shkak të faktit se kjo e drejte lidhet me perfaqesuesit e popullit dhe jo partitë përkatëse qe i delegojnë ata.** Ndryshe nga një konceptim i tillë, në kushtetuten tone ka dy nene të lidhura në mënyrë të drejtperdrejte apo të terthorte me partitë politike.

# Permbledhje e shkurter: Cfare jane Partite Politike?

- Partite formale jane shfaqur **kryesisht** ne fillim te viteve 1800-te
- Keto parti fillimisht nuk mbeshtesnin ndonje “ideologji” , por ishin te orientuara sipas problematikave konkrete.
- Rritja e demokracise dhe ngritja e kombeve te industrializuara i dha hov perfshirjes masive dhe rolit me te gjere te partive politike nga fundi i viteve 1800-te.
- Struktura e sistemit partiak dhe **liria e aplikuar brenda partive politike** ne kuader te shtetit komb reflekton nivelin e demokracise.
- **Lidhja parti-qeverisje**



# Cili eshte objektivi apo misioni i tyre?


## Se pari:

- Per te garantuar fuqi dhe influence
- Per te fituar ne zgjedhje sa me shume vende ne parlament per te kontrolluar (drejtuar) qeverisjen.

## Se dyti:

- Per te luajtur rolin e opozites – per te vezhguar/ kritikuar qeverine- duke zhvilluar alternativat e saj.

Roli i eneve komunikuese



# Çfarë bëjnë partitë politike?

- **1. Informojnë dhe aktivizojnë mbështetësit** - ato furnizojnë mbështetësit me informacion mbi probleme konkrete apo çështje të tjera dhe i motivojnë për një pjesëmarrje e mobilizim më të mirë.
- **2. Përcaktojnë kandidatët**, rekrutojnë e ndihmojnë kandidatët e zgjedhur. **Ndihmojnë në zgjedhjen e kandidatëve** më të mirë dhe më tej dhe të shtetarëve kryesorë apo zyrtarëve të tjerë- pra dhe përpiqen të furnizojnë kandidatë të sigurtë, të një karakteri të mirë dhe me moral të lartë.
- **3. Kontribuojnë për qeverisjen** - dhe kjo arrihet nëpërmjet aktivizimit të grupimeve partiake. P.sh., në Amerikë, kongresi dhe senati organizohen në linja partiake. Po ashtu dhe emërimet e ndryshme, (të karakterit politik) që arrijnë në nivelin qendror deri në **6000 pozicione**.
- **4. Partitë politike mund të planizojnë dhe realizojnë ndryshime legjislative e kushtetuese nepermjet referendumit popullor.**
- **5. Watchdog** – partitë luajne dhe rolin e një “watchdog” për partinë në pushtet, si pjese ne qeverisje apo si opozite.

# Tipet e ndryshme te Partive Politike:

**Tipologjia partiake** percaktohet nga **kriteret e organizimit, qëllimet politike, struktura e anëtarëve dhe funksioni politik**. Llojet partiake sipas mënyrës së organizimit janë p.sh.: **parti elitare apo parti të masave**. **Për partitë ideologjike botëkuptimi, interesat e orientimi programor është përcaktimi i qëllimeve politike**, ndërsa **për partitë popullore vete struktura e anëtarëve**. Sipas rolit funksional, ndeshet dhe dallimi midis partive “shtetërore” dhe atyre demokratike.

## Tipi Pragmatik (Populist)


- Orientim masiv, me teper populizem se lidhje te forta ideologjike; me teper nje sukses politik se nje ideologji politike .

## Tipi Ideologjik

- Perfshin nje varg parimesh te shkruara apo deklaruar.

## Interesa Speciale

- Organizimi realizohet rreth nje interesi apo ceshtje te vecante



# Llojet e Sistemeve Partiake

## One-Party States (**Shteti-Parti apo Partia-Shtet**)

- Vetem nje parti politike konsiderohet e ligjshme.
- Menjanohet gara politike.



Hitleri dhe Musolini

## Two-Party Competitive Systems (**Sistemet Kompetitive me dy Parti Politike**)

- Pushteti alternohet midis dy partive kryesore (gje qe nuk nenkupton se ekzistojne vetem keto dy parti)

## Two-Plus Party Systems (“Many Minor”)

### (**Sistemet e Partive 2 plus(me shume parti te vogla)**)

- Pushteti alternohet midis dy partive me te medha me nje mori partish te tjera te vogla qe ndikojne qeverisjen.

## Multi-Party Systems (**Sistemet shume partiake**)

- Pushteti alternohet midis 3 apo me shume partish politike, ato shpesh formojne koalicione per te kontrolluar qeverisjen.

# Kanada??

## 2-Plus Party System

Liberalet kundrejt  
Konservatoreve (krahas dy  
partive te tjera)

# Britania??

## 2-Plus Party System

Laburistet kundrejt  
Konservatoreve (plus  
Liberalet)

# Izraeli??

## Multi-Party System

12 parti paraqiten ne  
Knesset



# SHBA??

## 2-Party System

Republikanet e Demokratet

# Kina??

## One Party System

Partia Komuniste (por  
multi-party ne teori)

# Italia??

## Multi-Party System

3 koalicione ne qeverisje  
me nje mori te madhe  
partish

# Sistemi dypartiak amerikan

- **Sistemi politik amerikan ka filluar si një sistem me dy parti. Vetëm në raste të veçanta ka fituar zgjedhjet ndonjë kandidat jashtë dy partive kryesore, sepse sistemi elektoral nuk i favorizon kandidatët e grupimeve të vogla.**
- **Por, pse dy parti? Per tradite, shumica e amerikanëve e pranojnë këtë sistem sepse ashtu e kanë gjetur atë!**
- **Arsye historike:**Themeluesit e kushtetutës ishin kundër partive politike, duke lejuar kështu krijimin e dy grupimeve: federalistët dhe anti-federalistët. Me tej, gati menjëherë janë krijuar dy parti politike: **Partia Federaliste e Hamiltonit dhe Partia Demokratike-Republikane e Xhefersonit.** Në fillimet e veta kemi:
  - **Federalistët – njerëz të pasur dhe të shkolluar, që kërkonin thjesht një interpretim të vagët të kushtetutës, të mbështetur edhe prej bizneseve të mëdha**
  - **Demokrato-Republikanët – njerëz të zakonshëm (“common man”), që favorizonin një interpretim të rreptë të kushtetutës, mbështeteshin nga dyqanxhinjtë, punëtorët, fermerët e bujqit.****Konsensusi ideologjik amerikan-nuk ekzistojnë kushte plotësisht reale për të promovuar parti ashpërsisht rivale. Po ashtu mbështetet alternimi apo rotacioni politik!**

Të dy partitë tentojnë të pozicionohen në “mes të rrugës” për shumicën e çështjeve meqë dhe shumica e votuesve janë vetë të moderuar në pikëpamje bazike.

# Pak Histori

## 1800-1860•

Federalistët zgjodhën Adamsin (John Adams) dhe më tej partia u shkri (aty nga viti 1816).

Demokrato-Republikanët dominuan politikën amerikane deri në periudhën e Luftës Civile (1800 –1828), të njohur si “era of good feelings”. Partia u bë **Demokratike** më 1828 dhe ajo sfidohej nga ish anëtarët e njohur si Whigs, që arritën të zgjedhnin si presidentë herojtë e luftës W.H. Harrison (1840) dhe Taylor (1848).

## 1860 – 1932 •

Çështja e skllavërisë çoi në formimin e **Partisë Republikane**, që dominoi politikën amerikane për mbi 70 vjet. Në këtë periudhë demokratët arritën të zgjedhnin dy presidentë (1884, 1892) dhe (1912,1916). Republikanët fituan dhe në vitin 1896 megjithëse demokratët dhe populistët nominuan të njëjtin kandidat (Bryan). Wilson u zgjodh meqënë se T.R. Roosevelt kandidoi si progresist, duke copëtuar kështu votën republikane.

## 1932 - 1968•

**Depresioni i madh** u dha epërsi demokratëve. F.D.R. (Franklin Delano Roosevelt) u zgjodh 4 herë ( 1 vetmi i zgjedhur mbi 2 herë). Vetëm Eisenhower (hero popullor luftime) është zgjedhur si republikan (1952, 1956). **Shtojmë se viti 1932 shenoi një ndryshim të konsiderueshëm në rolin e qeverisë në ekonominë dhe jetën amerikane.**

## 1968 –deri tani

Era e ndarjes së qeverisjes, republikanët dhe demokratët kanë alternuar presidencën, shpesh në rezultate në zgjedhje shumë të afërta.


Nixon (R) 2 herë, Carter (D) një herë, Reagan (R) 2 herë, G.H.W. Bush (R) një herë, Clinton (D) 2 herë dhe G.W. Bush (R) 2 herë, Obama (D).

**Republikanët kanë dominuar më tepër presidencën, demokratët kongresin.**


# Parti minore

- Edhe sot në SHBA ka disa parti politike minore. Këtu mund të përfshihen të ashtuquajturit: **Libertarianët, Reformistët, Socialistët, Të gjelbrit**, etj. Shumë rrallë kandidatët e tyre mund të fitojnë ndonjë pozicion, por ama jo rrallë ato i ndikojnë zgjedhjet, madje deri duke influencuar dy partitë kryesore. Po ashtu, partitë e vogla luajnë një rol kritik pozitiv dhe shpesh gjenerojnë apo hedhin në fushën politike ide të vlefshme. **Në vitin 2000, në SHBA, gati 20 kandidatë të partive të vogla arritën të merrnin në total jo më shumë vota se ato të një shteti...**

# Shtetet e BE-se sipas grupimeve politike: gusht 2012



Partite	#	QMV	Perq. Pop.
Partia Popullore Evropiane	15	182	49.75%
Partia e Socialisteve Evropiane	5	65	19.05%
Aleanca e Konservatoreve dhe Reformisteve Evropiane	2	41	14.5%
Indipendentet	2	36	12.75%
Partia Demokratike Liberale e Reformiste	2	17	3.6%
Partia e te Majtes Evropiane	1	4	0.2%
<b>Totale</b>	<b>27</b>	<b>345</b>	<b>100%</b>

Group		Lideret		MEP
	<b>EPP</b>	<b>Joseph Daul</b>	<b>271</b>	
	<b>S&amp;D</b>	<b>Hannes Svoboda</b>	<b>189</b>	
	<b>ALDE</b>	<b>Guy Verhofstadt</b>	<b>85</b>	
	<b>G-EFA</b>	<b>Daniel Cohn- Bendit Rebecca Harms</b>	<b>59</b>	
	<b>ECR</b>	<b>Martin Callanan</b>	<b>52</b>	
	<b>GUE-NGL</b>	<b>Gabriele Zimmer</b>	<b>34</b>	
	<b>EFD</b>	<b>Nigel Farage Francesco Speroni</b>	<b>34</b>	
	<b>Te paregjistr.</b>	<b>MEP pa grup</b>	<b>30</b>	<b>Burimi: Parlamenti Evropian</b>

Ka 7 grupe parlamentare perfshire 30 deputete te paatashuar (non-inscrits). Dy grupet me te medhenj jane Partia Popullore Evropiane (EPP) dhe Grupi Socialist dhe Demokrat (S&D). Keto dy grupe kane zoteruar parlamentin gjate gjithe peridhes se ekzistences se tij (duke pasur se bashku 50-70 % te vendeve ne parlament). Asnje grup nuk ka pasur shumicen aty. Si pasoje e aleancave te partive kombetare, grupet parlamentare ne nivelin evropian jane teper te centralizuar dhe kane shume gjera te ngjashme me partite ne shtetet federale si Gjermania apo ShBA se shtetet shtetet unitare ne shumicen e vendeve te BE-se.

# Pak Histori Shqiptare

**Partia Popullore**, eshte krijuar vetem ne vitin 1920. Mbeshtetur ne dokumenta, ne historiografine shqiptare por edhe ne studimet e historianeve te huaj, theksohet se **Fan Noli** eshte shqiptari qe ka krijuar kete parti te pare ne historine shqiptare. Menjehere pas tij ishte **Mehdi Frasher** me krijimin e **Partise se Perparimit (Perparimtare)**, i hapi rrugen te ashtuquajturit pluralizem, (me karakteristikat e tij tipike shqiptare).

## 1920-1939

**Partia Popullore** me themelues **Fan Nolin** (nentor 1920) (aty, p.sh., **Ahmet Zogu**)  
**Partia e Perparimit** me kryetar **Mehdi Frasherin** (fillim 1921) (te tjere: **Shefqet Verlaci**, **Bajram Curri**, **Hasan Prishtina**, **Hoxha Kadriu**). Si Partia Popullore dhe ajo Perparimtare u shkrine ne vitin 1923, kohe kur ne krye te qeverise erdhi Ahmet Zogu. Nje vakuum i tille do te vazhdonte edhe 16 vjet me vone, kur ne Shqiperi do te themelohej partia e trete ne vend, ajo **Partia Fashiste Shqiptare** (4 dite pas pushtimit te Shqiperise). Sekretar i Pare i kesaj partie qe ne fillim ka qene **Tefik Mborja** nje avokat dhe dikur mbeshtetes i Fan Nolit. (Mbeshtetur ne arkivat shqiptare kjo parti ka nderruar disa emra si **Parti Fashiste Kombetare** e me pas **Roja Kombetare**; me kapitullimin e Italise mori fund dhe epoka e kesaj partie ).

## Tre partite e luftes.

**Partia Komuniste**-8 nentor 1941-Sekretar i pare Enver Hoxha . Edhe pse gjate kohes se Zogut nuk u krijua asnje parti politike, perpjekjet e individeve apo edhe grupeve te ndryshme nuk kane rreshtur. Madje veprimtaria komuniste ne vendin tone njihet qe ne vitin 1920. Me pushtimin e vendit u krijuan disa grupe komuniste (Shkoder, Korce, Tirane) qe u bashkuan ne krijimin e **Partise Komuniste Shqiptare**, qe me vone pas, pas clirimit u quajt **Partia e Punes se Shqiperise**, te konsideruar si buruese, **ne qershor te vitit 1991**, te **Partise Socialiste**.

## Partia e Ballit Kombetar

Eshte partia e dyte shqiptare e krijuar gjate kohes se luftes . Si date e pranuar per te eshte nentor 1942. Kryetar i Ballit Kombetar ishte **Mit'hat Frasheri** dhe forma e qeverisjes ishte **republika**. (figura te tjera: **Ali Kelcyra, Abaz Ermenji e Sejfi Protopapa**). Pas clirimit mjaft eksponente te saj u larguan jashte vendit, megjithate, kjo parti pati jete ne mergim ku u riorganizua me qellim rikthimin ne pushtet. Ne vitin 1992 kjo parti u rithemelua, por natyrisht programi dhe veprimtaria e saj kishte shume ndryshime nga ato te 50 viteve me pare.

## Partia e Legalitetit

Nje vite me vone u themelua partia e trete e luftes me emrin **Partia e Legalitetit**. Edhe pse ne program ajo nuk mbeshteste sistemin republikan, por ate **monarkist**, kjo parti pati lidhje te ngushta me Partine e Ballit Kombetar. Ishte tetori i vitit 1943, kur kjo parti u zyrtarizua dhe ne krye te ketij formacioni politik u vendos **Abaz Kupa**. (**Ahmet Zogu**- kryetar nderi). Ashtu si edhe Balli edhe kjo parti nuk e pati jete ne Shqiperine e pas luftes.

# - Partite shqiptare ne vite- 3-

Pas 90-es:

**Partia Demokratike** e themeluar ne 12 dhjetor 1990 i dha fund sundimit te sistemit nje-partiak (pas 46 vjetesh) dhe me tej jane krijuar **Partia Socialdemokrate, Partia Republikane**, etj, derisa sot jane te regjistruar mbi 50 parti, edhe pse vetem nje pjese e tyre eshte e perfaqesuar ne nivelin qendror apo vendor te qeverisjes.

1. Partia Popullore 1920
2. Partia Perparimtare 1921
3. Partia Fashiste 1939
4. Partia Komuniste 1941
5. Partia Balli Kombetar 1942
6. Partia e Legalitetit 1943
7. Partia Demokratike Shqiptare 1991
8. Partia e Bashkimit Demokratik Kombetar 1991
9. Partia Demokristiane 1991
10. Partia e Indipendenteve Centriste te Shqiperise 1991
11. Partia Perparimi Kombetar 1991
12. Partia e Blerte e Shqiperise 1991
13. Partia e Prosperitetit Demokratik 1991
14. Partia Ekologjike 1991

15. Partia Republikane 1991
16. Partia Nacional-Demokrate 1991
17. Partia Socialiste 1991
18. Partia Universale Shqiptare 1991
19. Partia e Unitetit dhe e Prosperitetit Kombetar
20. Partia Socialdemokrate 1991
21. Partia Agrare 1991
22. Partia Liberale 1992
23. Partia Lidhja Popullore Shqiptare 1992
24. Partia Socialpunetore Shqiptare 1992
25. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare 1992
26. Partia Bashkimi per te Drejtat e Njeriut 1992

27. Partia Nacionaliste Shqiptare 1992
28. Partia Levizja e Legalitetit 1992
29. Partia Beselidhja Kombetare Demokratike Shqiptare 1992
30. Partia Socialreformiste e Shiperise 1992
31. Partia Republikane e Djathte 1992
32. Partia Balli Kombetar 1992
33. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar 1993
34. Partia Konservatore
35. Partia Popullore Shqiptare 1994
36. Partia Drejtesia Shoqerore 1994
37. Partia progresi Popullor Shqiptar 1994
38. Partia Triumfi i Legalitetit 1995
39. Partia Ideali Demokratik 1995
40. Partia Konservatore 1995
41. Partia Mbrojtja e te Drejtave Kombetare 1995
42. Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar 1995
43. Partia Partia Kombetare e Legalitetit 1995
44. Partia Rimekembja Shqiptare 1996
45. Partia e Re Socialiste 1996

46. Partia Bashkesia Kombetare Shqiptare 1996
47. Partia Levizja per Dmokraci 1997
48. Partia Lidhja Fshatare 1997
49. Lidhja Kombetare Shqiptare 1997
50. Partia Komuniste Shqiptare 1998
51. Partia Komuniste e Rindertuar 1998
52. Partia e Re e Punes se Shqiperise 1998
53. Partia Qytetare Shqiptare 1998
54. Partia Alternative Liberale Shqiptare 1998
55. Partia Balli Kombetar Demokrat 1998
56. Partia Centriste e Mireqenies Popullore 1998
57. Partia e Pajtimit Kombetar 1998
58. Partia e Idealeve Komuniste 1998
59. Partia e Biznesit Shqiptar 1998
60. Partia e Emigracionit Shqiptar 1998
61. Partia Demokrate Reformatore 2000

# Shtojcë: Mbi “rrugën e tretë”

- Tranzicioni mbi dhjetëvjeçar shqiptar, në morinë e problematikave të lidhura me zhvillimin sa më të shpejt demokratik dhe instalimin e elementëve kryesorë të ekonomisë së tregut, riktheu në skenën e harruar të politikës moniste dhe koncepte si e “majta” dhe e “djathta”, më shumë të huazuar nga terminologjia politike europiane, sesa të lindura apo të rilindura në mënyrë natyrore në terrenin shqiptar, veçanërisht pa u mbështetur në **pronën dhe kategoritë e tjera ekonomike**. Dhe për këtë, me përjashtim të ndonjë partie me ekzistencë të para e gjatë luftës çlirimtare, flasin shumë më qartë programet e partive, të cilat ndryshojnë shumë pak ose aspak, edhe pse vetëklasifikohen si të majta, të djathta, të qendrës apo diku akoma me “stërhollim” më të ndërmjetëm. ...
- Për më tepër dhe koalicionet qeverisëse, të kompozuar nga parti, të deklaruara me pozicione të ndryshme partiake, pavarësisht pjesës së spektrit që i përkasin apo deklarojnë, kanë mbrojtur madje të njëjtin program politik qeverisës e reformash, të hartuar mbi bazën e programit të partisë, që ka përbërë maxhoranën parlamentare!...

## -2-

Rënia e “Murit të Berlinit” ka ndikuar thelbësisht në ndryshimin e perceptimit të konfiguracionit politik ndërkombtar, duke evoluar pjesën më të madhe të koncepteve për **zhvillimin shoqëror e ekonomik, për kombin, shtetin, qeverisjen, shoqërinë civile**, etj., me synimin për të shkuar tej neo-liberalizmit të të djathtës së vjetër, nga njera anë, dhe socialdemokracisë së para e menjëherë të pas Luftës së Dytë Botërore të Europës Perëndimore, nga ana tjetër, por jo për të “pajtuar” apo “njëhsuar” diferencat, tashmë “jashtë mode”, madje me karakter anakronik e ish antagonist midis tyre.

Gjithashtu, në kushtet e një procesi globalizimi gjithnjë e më intensiv, të cilit jo të gjithë i “thurrin lavdi”, kurse një pjesë tjetër ka objeksione në rritje, një nga sfidat kryesore, siç po duket, krahas modulimit social e moral të këtij procesi, është se bashkësia e **“qëndrueshme”** e biznesit, e mbështetur në **kapitale** dhe në **pronë**, dhe konceptet pragmatiste, që “udhëheqin” brënda kësaj bashkësie, po lëvizin dhe ndryshojnë më shpejt në këtë proces integrimi e globalizimi sesa ato në bashkësinë e politikës. Për më tepër që kjo e fundit, që ka karakter **rotacional** apo **të përkohshëm**, në sajë të sistemit demokratiko-zgjedhor dhe votës së lirë të zgjedhësve, nuk po arrin të reagojë në kohë në këtë proces globalizimi tregjesh e kapitalesh, ndaj problemeve shqetësuese si lufta kundër varfërisë globale, edukimi e modernizimi teknologjik global, mbrojtja sociale, ajo e shëndetit dhe e mjedisit, etj.

Pra, nga njera anë, politika duhet t’u përgjigjet sa më mire kërkesave për një standart më të lartë jetese të zgjedhësve të saj të drejtpërdrejtë, dhe, nga ana tjetër, ajo duhet të vihet edhe në shërbim të tretëve, të bëhet **sa më integruese, sa më globale e kontribuuese nga ana sociale, e ndërthurur dhe e ndërvarur**, duke cënuar kështu dhe interesat e vetë këtyre zgjedhësve, apo duke reaguuar e vepruar, jo në pak raste, jashtë interesave imediate të tyre. Këto janë arsye të mjaftueshme për të besuar në një evolucion më të shpejtë e të qartë të politikës në përgjithësi dhe asaj shqiptare në veçanti, në vitet që do të vijnë, pra dhe një riformim të saj, njëherësh në koncepte, sruktura e strategji veprimi e vlerësimi.

# Organizimi partiak

- Partitë politike në botën e sotme, gjithnjë e më shumë, janë duke u organizuar në mënyrë të zbehtë. Sidoqoftë, edhe si **parti elektorale ato ruajnë struktura kombëtare (brenda vendit dhe ne emigracion)**, struktura në nivel shtetëror dhe ato në nivel lokal.
- **Nje problem ne vete ai i decentralizimit në linja të ngjashme me atë të organizimit të pushtetit vendor. (Shqiperi)**
- Në SHBA, në nivel kombëtar, ka një kryetar partie që punon për fuqizimin e unitetit të partisë, për organizimin e Konventës së partisë, etj. **Për partinë që ka presidentin, ky i fundit luan rolin e liderit kryesor të partisë.** Në nivel të një shteti të veçantë kryetari i partisë shpesh herë kontrollohet nga nivele të tjera të larta. Ky lloj drejtuesi partie drejton fushatën e financimit, me strukturën përkatëse partiake ai rekruton kandidatë të ndryshëm, planizon e organizon konventën e shtetit të tij.
- Organizimet lokale janë të ndryshme.

# Perspektiva të partive politike

- **Orientimet dhe programet po bëhen gjithnjë e më të afërta**
- – Numri i militantëve apo votuesve që identifikohen me lehtësi është duke u zvogëluar.
- – Vihet re në vende të zhvilluar një rritje të numrit të pavendosurve.
- – Ndryshimet strukturore i kanë bërë partitë më “të hapura”, por duke i amplifikuar përplasjet e pakënaqësitë e brendshme
- – Ndikimet teknologjike sidomos në procese elektorale
- – Rruga e tretë (“The Third Way”, “Die Neue Mitte”, etj)
- **Paraqitja e rolit të votuesit në “kostumin” e konsumatorit.**

# Sisteme shumëpartiake

- Në shumë vende (përfshirë dhe Shqipërinë) sistemet politike përbëhen nga disa **parti kryesore (të mëdha) dhe disa parti të vogla** që garojnë për zyrat publike. Ndryshe themi se në mjaft vende evropiane **sistemet politike janë shumëpartiake**. (Me teper do te flasim ne Kap. II)
- Ata tentojnë të pasqyrojnë një paraqitje më diverse të spektrit politik, dhe nga ana tjetër përpiqen të ndërtojnë **koalicione për të arritur në kontrollin e qeverisjes**.
- Nga ana tjetër, një situatë e tillë në jo pak raste të çon në kriza qeveritare që provokohen nga pjesëtarët e koalicionit përkatës për ta rritur kontrollin apo mbajtjen e tij. (rasti i aleances qeverisese PDK dhe LDK ne Kosove)
- Në sisteme të tilla me **shumë parti politike** (me interesa specifike, ekonomike, fetare, sociale, etj.) shumë shpesh mungesa e stabilitetit lidhet dhe **me orientimet e ndryshme programore të grupimeve në koalicionin qeverisës**.
- –Rasti i koalicionit PD-LSI?

# Kategorizime të tjera

1. **Partitë Ideologjike** – ato bazohen në një bashkësi të veçantë idesh (marksistët, komunistët, etj.). Një lloj i tillë partie jeton për një kohë të gjatë nga që anëtarët e partisë janë tepër të orientuar ndaj kësaj ideologjie.

2. **Partitë që lidhen me një çështje të veçantë.** Ato përqendrohen në disa probleme konkrete p.sh. të politikës publike. Edhe emrat e tyre lidhen me synimet apo shqetësimet e tyre, p.sh. Partia për të Drejtën e Jetës (Aborti).

Zakonisht tematika të tilla i adopton dhe çdo parti kryesore gjë që e bën shumë më të prekshme apo të zëshme tematikën përkatëse. Për këtë arsye ato të voglat ose tërheqin një numër të vogël votuesish ose çështja për të cilën ato janë krijuar “vidhet” nga partia kryesore.

3. **Partitë që orientohen për nga protesta ekonomike** – sidomos ato marrin deri diku njëfarë vlere në periudha krize apo pakënaqësish ekonomike. Nuk kanë ndonjë ideologji udhëheqëse, veçse shprehin një zemërim të përgjithshëm në lidhje me kushtet e dhëna ekonomike e sociale.

4. **Partitë e reja pas ndarjes së një partie të madhe** (zakonisht rreth një personaliteti të fortë të asaj partie).

Mund të shmangët ky proces copëtimi ekzistenca dhe **përfaqësimi politik i fraksioneve** brenda një partie të madhe.

# Sistemi politik njëpartiak

- Ende, në disa vende kemi të bëjmë me diktatura. I tillë është rasti i një sistemi komunist të sunduar nga një parti e vetme. Në këtë rast votohet vetëm për një parti! Apo, **situatë kjo e ngjashme me atë të mungesës së një sistemi partiak...**
- **Një shembull amerikan:** Ka zona ku njëra parti është shumë e fortë, saqë mund të konsiderohet në njëfarë mënyre si një sistem politik njëpartiak. Kështu, p.sh., Jugu midis viteve 1865-1960 ka votuar gjithmonë demokratët, kurse gjatë kësaj kohe në New England apo Miduestin e sipërm votoheshin republikanët.
- **Shembulli shqiptar,** në disa zona ku kanë fituar vetëm socialistët apo vetëm demokratët. Sistemi aktual elektoral ka sjellë disa ndryshime permbajtesore!